



**STATUTI I QENDRES**  
**“QENDRESA QYTETARE”**

Ne mbështetje të legjislacionit civil shqiptar dhe kryesisht në ligjin nr. 8788, dt.07.05.2001 "Për Organizatat Jo-fitimprurëse" dhe në Ligjin nr. 8789 dt. 07.05.2001 "Për Rregjistrimin e Organizatave Jo-fitimprurëse" vendosëm hartimin e këtij Statuti, me kushtet që përçaktohen si më poshtë:

**KREU I**

**Neni 1**

Qendra “QENDRESA QYTETARE” do të jetë një qendër jofitimprurëse.

**STEMA DHE VULA**

**Neni 2**

Qendra “QENDRESA QYTETARE” ka vullen dhe emblemen e saj të përcaktuar në krijimin e saj ligjor me inicialet **QQ**.

**SELIA**

**Neni 3**

Qendra do të ketë selinë e saj qendrore në Tiranë në adresën Sheshi "Avni Rustemi", Rruga "Hoxha Tahsim", Pall."Vjero", AP.A17/A, Tiranë.

**KOHEZGJATJA E QENDRES**

**Neni 4**

Qendra “QENDRESA QYTETARE” do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një kohë të pacaktuar.

**JURIDIKSIONI**

**Neni 5**

Qendra “QENDRESA QYTETARE” do të ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

## THEMELUESI

### Neni 6

Anëtar themelues i Qendrës është:

**-Rigels Xhemollari, lindur më 13/11/1987 në Pogradec dhe banues në Tiranë me nr.ID I71113063N (Themelues)**

## QELLIMI DHE OBJEKTIVAT E QENDRES

### Neni 7

Qëllimi ynë është të mbrojmë dinjitetin dhe personalitetin njerëzor dhe të forcojmë qytetarinë nëpërmjet depolitizimit, orientimit drejt iniciativës së lirë, promovimit të biznesit dhe kreativitetit rinor, rritjes së vigjilencës së konsumatorit, rritjes së ndërgjegjes kombëtare dhe orientimit drejt një arsimit cilësor.

### OBJEKTIVAT E QENDRES:

1. Forcimi komuniteteve qytetare ne lagje, shkolla dhe njësi administrative
2. Advokimi për një shërbim publik dinjitoz ndaj qytetarit
3. Mbrojtja e Konsumatorit bazuar në Strategjitë kombëtare dhe ligjet në fuqi
4. Rritja e ndërgjegjes kombëtare dhe promovimi i një sistemi arsimor cilësor
5. Mbrojtja nga diskriminimi dhe dhuna në institucionet publike dhe familje

## BURIMET FINANCIARE

### Neni 8

Qendra "QENDRESA QYTETARE" ka qellime jofitimpruese.

### Neni 9

#### Burimet financiare të qendrës janë si më poshtë:

- Donacione ose sponsorizime private ose nga individë, institucione qeveritare dhe joqeveritare, vendase ose te huaja që do të mbështesin realizimin e qëllimit të qendrës.
- Të ardhura nga pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në përputhje me legjislacionin ekzistues.
- Kontribute nga themeluesit.
- Të ardhura nga aktiviteti ekonomik jofitimprurës apo administrimi i pasurive

Në çdo rast do të bëhet evidentimi i këtyre mjeteve financiare dhe do të hartohet dokumentacioni përkatës sipas ligjeve në fuqi.



- Kontributi fillestar i themeluesit është 10.000 leke të reja.
- Qendra nuk pranon donacione ose financime të shoqëruara me kushte që do të kufizonin lirinë e saj të vendosjes ose veprimit.
- Kapitali i qendrës duhet të përdoret ekskluzivisht për arritjen e qëllimeve të saj.
- Borxhet e qendrës janë të pagueshme vetëm nga kapitali i vetë qendrës. Çdo përgjegjësi personale e drejtuesve është e përjashtuar, përveç dëmeve të shkaktuara për fajin e këtyre të fundit.
- Drejtuesit nuk kanë të drejta mbi kapitalin e qendrës dhe ndalohet shpërndarja e fitimit midis tyre.
- Miratimi i personave që do të merren me ceshtjet financiare të shoqatës, është kompetencë e Bordit Drejtues.

#### **Neni 10**

1. Qendra nuk pranon dhurata apo sponsorizime nga persona fizik apo juridik, kombëtarë apo ndërkombëtarë, që nuk respektojnë të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe dëmtojnë interes kombëtarë shqiptarë në të gjithë botën.
2. Te ardhurat e qendres do te depozitohen ne nje nga Bankat e qytetit te Tiranës, ku qendra do te kete nje numer llogarie nepermjet te cilit do te kryhen te gjitha levizjet e fondeve.

## **KREU II**

### **ORGANET DREJTUESE TE QENDRES DHE KOPETENCAT E TYRE**

#### **ORGANET DREJTUESE**

##### **Neni 11**

Organi me i larte i Qendrës është Bordi Drejtues qe mblidhet te paktën katër here ne vit. Ne mbledhjen e themelimit si Drejtor Ekzekutiv i saj u zgjodh Rigës XHEMOLLARI, i cili është i autorizuar te ndjeke procedurat e nevojshme për regjistrimin e organizatës dhe përfaqësimin e saj me të tretët.

Organizata “QENDRESA QYTETARE” u krijua dhe vepron në baze të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 8788 date 07.05.2001, për organizatat jofitimprurëse me aktin e saj te themelimit dhe statutin bashkëngjitur.



## **KOMPETENCAT E BORDIT DREJTUES**

### **Neni 12**

Bordi Drejtues përveç çështjeve të tjera të cilat ai i çmon se duhet të shqyrtohen prej tij vendos për:

- Ndryshimin e Statutit.
- Përcaktimin e fushes dhe programit te veprimtarisë së Qendrës.
- Mbikqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e veprimtarisë së Qendrës.
- Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit të Qendrës.
- Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, organizimin dhe strukturën e Qendrës.
- Zgjedh dhe emëron anëtarët e organit më të lartë ekzekutiv.
- Krijon komitetet e posaçme dhe pozicionet administrative.

## **DREJTORI EKZEKUTIV**

### **Neni 13**

Organi më i lartë ekzekutiv i Qendrës është Drejtori Ekzekutiv. Drejtori Ekzekutiv zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve për njëmandat 3- vjecar me të drejtëri-mandatimi. Ai e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit.

## **KOMPETENCAT E DREJTORIT EKZEKUTIV**

### **Neni 14**

Drejtori Ekzekutiv gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij ka këto kompetenca:

- Perfaqeson qendren ne marredhenie me te tretet.
- Realizon veprimtarinë e përditshrne dhe ekzekuton programet e vendosura nga organi më i lartë vendimmarrës.
- Përgatit projekt programin vjetor të aktiviteteve dhe projekt buxhetin të cilat ia paraqet për miratim Bordit Drejtues.
- Kordinon punen e Bordit dhe propozon projektet per donatoret.
- Administron fondet sipas mënyrës së caktuar nga Bordi Drejtues.
- Mban vulën e Qendres.

### KREU III

#### PROCEDURAT E VENDIMMARRJES NE QENDREN "QENDRESA QYTETARE"

##### Neni 15

Vendimet e Bordit Drejtues merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të tij.

Vendimet për ndryshimin e Statutit, të Aktit të Themelimit, për miratimin e rregulloreve të brendshme merren me 2/3 e votave.

##### Neni 16

Mbledhjet e Bordit Drejtues së Qendrës thirren me kërkesën e Drejtorit Ekzekutiv, në varësi të projekteve dhe veprimtarisë, por asnjëherë më rrallë se 1 (një) here në katër muaj.

Vendimet merren me shumicën e votave, dhe Drejtori Ekzekutiv ka të drejten e votes. Bordi Drejtues i Qendrës mblidhet edhe në rast të ndonjë kerkese të motivuar dhe të firmosur, nga të paktën nga 1/3 e anëtarëve të Bordit.

### KREU IV

#### SHPERNDARJA E QENDRES

##### Neni 17

Qendra shperndahet me vendim të drejtorit ekzekutiv dhe mbështetjen e Bordit Drejtues. Bashkimi i qendres me organizma te tjere vendoset nga drejtori i saj me mbështetjen e bordit dhe në ato raste kur misionet e organizatave plotesojne njera -tjetren.

##### Neni 18

Mbas shpërndarjes se Qendrës, likuidimi apo shperndarja e pasurive te saj behet ne baze te legjislacionit ne fuqi dhe ne baze te parimit të ndalimit te shperndarjes se fitimeve.

### KREU V

#### DISPOZITA KALIMTARE

##### Neni 19

Ne lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ketij statuti dhe per ç'ka nuk është shprehur ne statut, veprimtaria e Qendres rregullohet nga legjislacioni që është në fuqi per organizatat jofitimpruese.

## Neni 20

Bordi i pare Drejtues perbehet nga 5 anetare te cilet jane:

1. Drejtor ekzekutiv Rigels Xhemollari
2. Anetar i Bordit Drejtues Ines Mulellari
3. Anetar i Bordit Drejtues Migel Zallemi
4. Anetar i Bordit Drejtues Altin Collaku
5. Anetar i Bordit Drejtues Valmira Kosova

Drejtor Ekzekutiv u zgjodh z. Rigels Xhemollari.

## THEMELUESI I QENDRES

-Rigels Xhemollari, lindur më 13/11/1987 në Pogradec dhe banues në Tiranë me nr.ID 171113063N (Themelues)

Rigels Xhemollari



## AKTI I THEMELIMIT TE QENDRES

### “QENDRESA QYTETARE”



Ne mbështetje të ligjit 8788 date 07.05.2001 dhe ligjit 7580, date 29.07.1994, hartohet ky akt themelimi i Qendrës “QENDRESA QYTETARE”.

Kjo qendër është një organizëm i krijuar me vullnet të lire të themeluesit të saj pa asnjë qëllim fitimi, joqeveritare dhe e pavarur.

#### EMERTIMI I QENDRES

Emërtimi i Qendrës do të jetë: “QENDRESA QYTETARE”.

#### KOHEZGJATJA E QENDRES

Qendra “QENDRESA QYTETARE” do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një kohë të pacaktuar.

#### JURIDIKSIONI

Qendra “QENDRESA QYTETARE” do të ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

#### MISIONI I QENDRES

Qëndresa qytetare do të jetë hapësira për ata shqiptarë që besojmë tek pushteti i qytetarit dhe që janë të vendosur për të mos qenë pjesë e sistemit politik. Të jesh një qytetar me pushtet është më mirë se të pretendosh karrigen e një pushtetari.

#### QELLIMI I QENDRES

Qëllimi ynë është të mbrojmë dinjitetin dhe personalitetin njerëzor dhe të forcojmë qytetarinë nëpërmjet depolitizimit, orientimit drejt iniciativës së lirë, promovimit të biznesit dhe kreativitetit rinor, rritjes së vigjilencës së konsumatorit, rritjes së ndërgjegjes kombëtare dhe orientimit drejt një arsimit cilësor.

#### OBJEKTIVAT E QENDRES:

1. Forcimi komuniteteve qytetare në lagje, shkolla dhe njësi administrative
2. Advokimi për një shërbim publik dinjitoz ndaj qytetarit
3. Mbrojtja e Konsumatorit bazuar në Strategjitë kombëtare dhe ligjet në fuqi
4. Rritja e ndërgjegjes kombëtare dhe promovimi i një sistemi arsimor cilësor
5. Mbrojtja nga diskriminimi dhe dhuna në institucionet publike dhe familje

## BURIMET FINANCIARE

### Burimet financiare të qendrës janë si më poshtë:

- Donacione ose sponsorizime private ose nga individë, institucione qeveritare dhe joqeveritare, vendase ose te huaja që do të mbështesin realizimin e qëllimit të qendrës.
- Të ardhura nga pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në përputhje me legjislacionin ekzistues.
- Kontribute nga themeluesit.
- Të ardhura nga aktiviteti ekonomik jofitimprurës apo administrimi i pasurive

Në çdo rast do të bëhet evidentimi i këtyre mjeteve financiare dhe do të hartohet dokumentacioni përkatës sipas ligjeve në fuqi.

- Kontributi fillestar i themeluesit është 10.000 leke të reja.
- Qendra nuk pranon donacione ose financime të shoqëruara me kushte që do të kufizonin lirinë e saj të vendosjes ose veprimit.
- Kapitali i qendrës duhet të përdoret ekskluzivisht për arritjen e qëllimeve të saj.
- Borxhet e qendrës janë të pagueshme vetëm nga kapitali i vetë qendrës. Çdo përgjegjësi personale e drejtuesve është e përjashtuar, përveç dëmeve të shkaktuara për fajin e këtyre të fundit.
- Drejtuesit nuk kanë të drejta mbi kapitalin e qendrës dhe ndalohet shpërndarja e fitimit midis tyre.
- Miratimi i personave që do të merren me ceshtjet financiare të shoqatës, është kompetencë e Bordit Drejtues.

## ORGANET DREJTUESE

Organi më i lartë i Qendrës është Bordi Drejtues që mblidhet te paktën katër here në vit. Në mbledhjen e themelimit si Drejtor Ekzekutiv i saj u zgjodh Rigës XHEMOLLARI, i cili është i autorizuar të ndjeke procedurat e nevojshme për regjistrimin e organizatës dhe përfaqësimin e saj me të tretët.

Organizata "QENDRESA QYTETARE" u krijua dhe vepron në baze të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 8788 date 07.05.2001, për organizatat jofitimprurëse me aktin e saj të themelimit dhe statutin bashkëngjitur.

Ky akt u redaktua dhe u nënshkrua nga :

**-Rigels Xhemollari, lindur më 13/11/1987 në Pogradec dhe banues në Tiranë me nr.ID I71113063N (Themelues)**

*Rigels Xhemollari*





## PROCESVERBAL I THEMELIT TE QENDRES

### “QENDRESA QYTETARE”

Sot me 15.07.2016, në qytetin e Tiranës, mbahet ky procesverbal i themelimit të qendrës, në mbështetje të ligjit Nr.8788 datë 07.05.2001 “Per Organizatat Jofitimprurese” dhe ligjit 7580, date 29.07.1994, neni 39-53 te kodit civil.

#### U vendos:

a.Zgjedhja e Drejtorit Drejtues të Qendrës z. **Rigels XHEMOLLARI**

b.Miratimin e statutit te saj.

c.Zgjedhjen e Bordit Drejtues te Qendrës:

- 1.Drejtor ekzekutiv Rigels Xhemollari
- 2.Anetar i Bordit Drejtues Ines Mulellari
- 3.Anetar i Bordit Drejtues Migel Zallemi
- 4.Anetar i Bordit Drejtues Altin Collaku
- 5.Anetar i Bordit Drejtues Valmira Kosova

Autorizojme Drejtorin Ekzekutiv te Qendres, z.Rigels Xhemollari ti drejtohet Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane në procesin gjyqësor për rregjistrimin e qendres si person juridik si dhe te nenshkruaje statutin.

#### Anëtar themelues:

-Rigels Xhemollari, lindur më 13/11/1987 në Pogradec dhe banues në Tiranë me nr.ID 171113063N (Themelues)

Rigels Xhemollari  
